

Për cilët individë vlen detyrimi për mbajtjen e maskës në shkolla duke filluar nga data 26 tetor?

Duke filluar nga data 26 tetor të gjithë nxënësit dhe nxënëset në ndërtesat dhe ambientet e shkollave duhet të mbajnë një maskë për mbulimin e gojës dhe të hundës. Nxënësit dhe nxënëset duke filluar nga klasa e pestë duhet të mbajnë gjithashtu një maskë kur janë të ulur në bankë dhe gjatë mësimin.

A duhet të mbajnë gjithashtu maskë nxënësit dhe nxënëset e shkollës fillore?

Nxënësit dhe nxënëset e klasave të shkollës fillore nuk duhet të mbajnë një maskë për mbulimin e hundës dhe të gojës për sa kohë qëndrojnë në klasë, në mjediset e mësimdhënies. Në ndërtesa dhe mjedise të tjera shkollore vlen po njësoj detyrimi për mbajtjen e maskës.

Cilët individë nuk janë të detyruar të mbajnë maskën në shkolla?

Të gjithë personat të cilët qëndrojnë në ndërtesat dhe në terrenin e shkollës përgjatë hapësirës së veprimtarisë shkollore, janë kryesisht të detyruar të mbajnë një maskë për mbulimin e gojës dhe të hundës. Personat e përjashtuar nga ky rregull janë vetëm ata të cilët për arsye mjekësore nuk mbajnë dot një maskë për mbulimin e hundës ose të gojës. Këtë gjë ata duhet ta vërtetojnë nëpërmjet një çertifikate mjekësore, e cila duhet paraqitet sipas kërkesës.

Nxënësit dhe nxënëset e klasave të shkollës fillore nuk duhet të mbajnë një maskë për mbulimin e hundës dhe të gojës për sa kohë që qëndrojnë në klasë, në mjediset e mësimdhënies.

Për më tepër mësuesit, stafi përkujdesës dhe pjesa tjetër e stafit nuk janë të detyruar të mbajnë maska nëse zbatohet distancimi minimal prej 1.5 metrash me njerëzit e tjerë në dhomë. Gjatë konferencave, takimeve dhe qëndrimit në karrige tek salla e mësuesve, mund të hiqet dorë nga rregulli i mbajtjes së distancës minimale nëse sigurohet gjurmueshmëria e veçantë sipas seksionit 2a, paragrafi 2 të Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi nëpërmjet vendeve fikse të qëndrimit dhe një plani për vendet ku do ulen individët.

Detyrimi për mbajtjen e maskës nuk është gjithashtu i nevojshëm gjatë qëndrimit ulur në mensat e shkollave (sipas seksionit 14, paragrafi 2 të Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi).

Nuk janë të detyruar të mbajnë gjithashtu maska të cilat mbulojnë hundën dhe gojën nxënësit dhe nxënëset të cilët marrin pjesë në mjediset ku ofrohet përkujdesje gjatë gjithë ditës për fëmijët dhe qëndrojnë brenda dhomave të përkujdesjes për fëmijë ose në zona të caktuara të jashtme. Kjo vlen gjithashtu për rastet kur përkujdesja zhvillohet në grupe fikse dhe është e pamundur për grupe të ndryshme përkujdesje të përzihen me njëra-tjetrën.

Nuk ka gjithashtu detyrim për mbajtjen e maskave për antarët e komiteteve për bashkëpunimin e shkollave, nëse zbatohet distancimi minimal prej 1.5 metrash me njerëzit e tjerë në dhomë. Distanca minimale mund të injorohet nëse garantohet gjurmueshmëria e veçantë sipas seksionit 2a, paragrafi 2 i Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi.

A duhet të mbajë fëmija im gjithashtu një maskë gjatë pushimeve të shkurtra në oborrin e shkollës?

Gjatë pushimeve të shkurtra, lejohet të mos mbahet maska e cila mbulon hundën dhe gojën gjatë ngrënies dhe pirjes nëse zbatohet distanca minimale prej 1.5 metrash me individët e tjerë në terrenin e shkollës ose nëse ushqimet dhe pijet konsumohen brenda vendeve fikse në klasë.

Çfarë paraqesin rregullat për ajrosjen e duhur në shkollë?

Ajrosja në hapësirat e shkollave përbën një kontribut thelbësor dhe efektiv për reduktimin e ndjeshëm të rrezikut të infektimit me koronavirusin nëpërmjet aerosol-eve. Shkollat në Nordrhein-Westfalen do të ndjekin rekomandimet më të fundit të Agjensisë Federale për Mjedisin. Këto përfshijnë: Ajrosjen totale (hapje komplet e dritareve dhe dyerve) çdo 20 minuta, ajrosjen tërthore kurdo që të jetë e mundur (hapja e dyerve dhe e dritareve në anë të kundërta të murit që të kemi korrent ajri) dhe ajrosjet e dhomave gjatë gjithë pushimit të shkurtër.

A ka rregulla të reja në lidhje me edukimin fizik?

Situata ende e tensionuar e infeksionit nuk e bën akoma të mundur zhvillimin e sporteve në shkollë pa kufizime. Rregulloret për higjienën dhe për mbrojtjen nga infeksionet duhet të merren në konsideratë në mënyrë të përshtatshme dhe me shumë kujdes. Gjithsesi, është e rëndësishme që sportet në shkollë, veçanërisht edukimi fizik, të zënë vend në situatën aktuale në mënyrë që të krijohen mundësi për stërvitje, të promovohet shëndeti, të ofrohet një balancë në lidhje me situatën e jashtëzakonshme në sistemin shkollor dhe për përgatitjen për sportet praktike në lidhje me Abitur dhe programet e tjera edukative.

Për shkak të kushteve të motit, edukimi fizik do të zhvillohet normalisht pas pushimeve të vjeshtës tek sallat e sportit. Kushti për shfrytëzimin e sallave të sportit është një situatë ajrosje e cila lejon ndërrimin e ajrit dhe redukton përqëndrimin e aerosolit tek ajri i sallave të sportit.

Situata e shfrytëzimit të sallave do të analizohet në nivel vendor nga organet drejtuese dhe përgjegjëse të shkollave në koordinim me autoritetet dhe institucionet përkatëse dhe sallat do të vendosen në përputhje me rrethanat në dispozicion.

Mësuesit duhet të nxisin aktivisht ajrosjen tërthore duke hapur dyert dhe/ose dritaret. Në rastet e sallave të shumëfishta, muret ndarëse duhet të ngrihen pas çdo ore.

Mund të gjeni informacione të mëtejshme tek [faqja e internetit e Ministrisë për Shkollat](#).